



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA



Numri i lëndës: 2018:059683
Datë: 26.12.2018
Numri i dokumentit: 00195481

P.nr.1380/14

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - DEPARTAMENTI I PERGJITHSHEM DIVIZIONI PENAL, si gjykatë e shkallës së parë penale, në përbërje gjyqtarja, Hysnije Gashi, dhe zyrtaren ligjore Albana Ujupi, në çështjen penale kundër të pandehurit, [REDACTED] nga Ferizaj, rr. [REDACTED], për shkak të veprës penale vjedhja e rënde nga neni 327 par. 1 pika 1.1 të KPRK-së, sipas aktakuzave së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP.nr.645-6/14 te datës 12.12.2014 në praninë e përfaqësuesit të akuzës - Prokurorit të shtetit, Abdullah Abedini, të pandehurit, [REDACTED], pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar më dt.19.12.2018, morri dhe publikisht shpalli këtë :

AKT GJYKIM

I pandehuri:

[REDACTED], nga Ferizaj, rr. [REDACTED], nga i ati [REDACTED], ëma [REDACTED], i gjinisë [REDACTED], i lindur me [REDACTED], në Ferizaj, i pa punë, i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas e Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

1.Me datën 21.11.2013, rreth orës 03:00 ne rrugën “Besim Rexhepi” ne Ferizaj, ne bashkëveprim me personin e mitur [REDAKTUAR], me qellim qe me përvetësimin e sendeve te huaja te luajtshme e qe vetit ti sjell përfitim pasuror te kundërligjshëm, kane vepruar ne atë mënyrë qe me force kane thyer fillimisht drynin e pastaj e kane hapur derën e marketit “Albana” prone e te dëmtuarit [REDAKTUAR], kane hyre brenda ne market dhe nga aty kishin marre cigare te llojeve te ndryshme dhe atë: dy shtega cigare “Lycky”, nje “Malboro”, nje “West” dhe disa zhetona te bilardos dhe pasi qe ishin larguar nga marketi ishin ndaluar nga punëtorët e sigurimit “Skifiterat live”, vlerat e demit sipas te dëmtuarit sillet rreth 65€.

Me këtë kreu veprën penale vjedhja e rënde nga neni 327 par 1 pika 1.1 të KPRK-së

Andaj Gjykata në bazë nenit 378 dhe neneve 4, 7, 21, 41, 49, 50, 51, 52,73 , të KPRK-ës, dhe nenit 365 të KPPK-ës, e

G J Y K O N

ME DËNIM BURGIMI NË KOHËZGJATJE PREJ 1/një/ VITI i cili denim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

ME DËNIM ME GJOBË në shumë prej 200 € (dyqind) euro të cilin denim është i obliguar që ta paguaj ne afat prej 30 ditësh, pasi aktgjykimi të merr formën e prerë.

Në rast se dënimi me gjobë nuk mundë të ekzekutohet në format tjera sipas nenit 46 par.3 të KPRK-së, i njëjti do ti shndërrohet në denim burgu ashtu që për çdo 20 euro, do ti llogaritet 1(një) ditë burg.

I dëmtuari [REDAKTUAR] nga Ferizaj, Rr. [REDAKTUAR]” nr. [REDAKTUAR] per realizimin e kerkeses pasurore juridike udhëzohet ne kontest civil.

Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20/njezetë/€, në afat prej 15 ditëve, nga data kur aktgjykimi merr formën e prerë nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Detyrohet i akuzuari që për kompensimin e Viktimave të Krimit ta paguaj shumën prej 30€ (tridhjetë/euro), brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Arsy e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj Departamenti i përgjithshëm, me aktakuzat PP.nr.645-6/14 te datës 12.12.2014 e ka ngarkuar të pandehurin [REDAKTUAR], për veprën penale vjedhja e rënde nga neni 327 par. 1 pika. 1.1 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj çështje penale mbajti shqyrtimin fillestar më dt. 19.12.2018 në të cilin Prokurori i Shtetit, Avdullah Abedini, në tërësi mbeti pranë aktakuzes, duke i propozuar gjykatës që te pandehurin të shpallë fajtor dhe të i shqiptoi sanksion penal sipas ligjit.

I pandehuri [REDAKTUAR], ne shqyrtimin fillestar, me rastin e njoftimit nga gjyqtarja për drejtën e tij që të pranoj fajësinë apo të deklarohet i pa fajshëm në kuptim të nenin 248 të KPPK-së ka deklaruar se e pranon fajësinë për te gjitha pikat e aktakuzës, duke theksuar se për këtë vepër është penduar thellë, duke premtuar se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra penale të kësaj natyre, dhe i propozon gjykatës që ti shqipton ndonjë dënim sa më të butë.

Me që i pandehuri ka pranuar fajësinë gjykata ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara me dispozitën e nenit 248 par.1 të KPPK-së:

-i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit,

-pranimi është bërë vullnetarisht nga i pandehuri,

-pranimi i fajit mbështetët në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit, deklarata e te pandehurit, te dëmtuarit dhe dëshmitarit dhe ne provat tjera te cilat gjinden ne shkresën e lendes.

Meqenëse i pandehuri ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përcaktuara me nenin 248 par.1 të KPPK-së, gjykata konform nenit 248 par.4 të KPPK-së ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale veprën penale vjedhja e rënde nga neni 327 par 1 nën par 1.1 të KPRK-së.

Gjykata, ka konstatuar se ekzistojnë rrethanat lehtësuese, të cilat tregojnë se edhe me dënimin më të butë mund të arrihet qëllimi I dënimit kështu që në kuptim të nenit 75,76 të KPRK-së aplikoi dispozitat për zbutjen e dënimit, Gjykata bëri zbutjen e dënimit duke marrë rrethanat lehtësuese, pranimin e fajsisë nga ana e të akuzuarit, kërkim falja publike . Kështu që konformë nenit 75,76 të KPRK-së, gjykata bëri zbutjen e dënimit nën kufit e paraparë të minimumit ligjor nga 3 vjet burgim si minimum ligjor në 1 (vit) burgim , si rrethane rënduese, gjykata morri faktin se i njëjti është duke e vuajtur denimn per veprat penale :grabitje, vjedhje e rende dhe vrasje ne tentative , gjykata vlerësoi shkallen e përgjegjësisë penale të të pandehurit dhe rrezikshmerinë konkrete të veprës penale, andaj duke marrë parasysh tërësinë e këtyre rrethanave, të pandehurit i shqiptoi denim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindjen se në rastin konkret do të arrihet qëllimi i dënimit të preventives speciale dhe asaj gjenerale, ku një dënim i tillë është adekuat dhe në proporcion të drejtë në raport me peshën e veprës penale, rrethanave të kryerjes së vepres penale, shkallen e përgjegjësisë penale dhe personalitetin e të pandehurit.

I dëmtuari [REDAKTUAR] nga Ferizaj, Rr. "[REDAKTUAR]" nr. [REDAKTUAR] per realizimin e kerkeses pasurore juridike udhzohe ne kontest civil.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 (njetzetë euro) në afatin prej 15 ditëve pasi që aktgjykimi të marr formën e prerë nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

Numri i lëndës: 2018:059683
Datë: 26.12.2018
Numri i dokumentit: 00195481

Detyrohet i akuzuari që për kompensimin e Viktimave të Krimit ta paguaj shumën prej 30€(tridhjetë/euro), brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi udhëzimin e realizimit të kërkesës pasurore-juridike është marr në kuptim të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së

Në bazë të së theksuarës më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - DEPARTAMENTI I PERGJITHSHEM –
DIVIZIONI PENAL**

P.nr.1380/14 dt.20.12.2018

Zyrtare ligjore
Albana Ujupi



Gjyqtarja:
Hysnije Gashi

KËSHILLA JURIDIKE

kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit Gjykatës së APELIT në Prishtinë përmes kësaj gjykate.